

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pakistani: Ngushticat e Hormuzit dhe Bab al-Mandab duhet të mbeten të hapura
ADRESA	https://piranjat.al/bota/pakistani-ngushticat-e-hormuzit-dhe-bab-al-mandab-duhet-te-mbet-en-te-hapura-i106120
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 20:16:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 20:03:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3ed2e220fa75ad15a99a14fdafdd21dc4a44c7de84570392381fcaa766f4b019
TEKSTI	aeb918b5a1b8b83245c1143826a4653b454cf214145826c18e2e18128da1c62b
PAMJA	7dd309d0a84bc41f45f424ee96abb3fae9d17109897f57d43d072e6c0ea89005

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7b1d5f824bda338b445f43f6528d7b1c1cfde2fc7993ef10e5ce6bd0a4431e8e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7b1d5f824bda338b445f43f6528d7b1c1cfde2fc7993ef10e5ce6bd0a4431e8e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [ne Shqipëri për](#) [Shqipëri](#) herë nga Shqipëria. Herën e [Shqipëri](#) [regulloreje/ Kush është](#) [regulloreje/ Kush është](#) [Marqinet të qytetit të Morës](#) [Pse nesht kryeministri për](#) [Pse nesht kryeministri për](#) [me të rëndësishme të sigurisë](#) [ndodh me policin Altin](#) [ndodh me policin Altin](#) [historinë e përplasjeve të tij me](#) [vazhdojnë. Cili është](#) [vazhdojnë. Cili është](#) [justifikimi i](#) [justifikimi i](#) [napestra aktuale do t'i nënshtrohet](#)

[BOTA](#)

Pakistani: Ngushticat e Hormuzit dhe Bab al-Mandab duhet të mbeten të hapura

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 22:03



Kryeministri i Pakistanit, Shehbaz Sharif, ka bërë thirrje për mbajtjen të hapura të Ngushticës së Hormuzit dhe asaj të Bab al-Mandabit, duke i cilësuar ato si “arterie” të ekonomisë globale.

Duke folur para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në New York, Sharif tha se në një kohë konfliktesh dhe tensionesh, diplomacia duhet të dëgjohet më fort.

“Mes zhurmës së raketave, dronëve dhe armëve, zëri për diplomaci duhet të jehojë edhe më fort”, tha ai.

Sipas Sharif, të dyja ngushticat duhet të mbeten të hapura dhe të shërbejnë si pika lidhëse mes kombeve, në vend që të kthehen në qendra përplasjesh.

Pakistani dhe përpjekjet për ndërmjetësim

Sharif përmendi gjithashtu rolin e Pakistanit në përpjekjet për uljen e tensioneve mes Iranit dhe SHBA-së. Sipas tij, Pakistani kishte ndihmuar në sigurimin e një armëpushimi dhe më vonë kishte pritur bisedime mes zyrtarëve amerikanë dhe iranianë.

Ai tha se një marrëveshje e ndërmjetësuar nga Pakistani në qershor u kishte ofruar palëve një kornizë për negociata afatgjata, por përplasjet mes tyre kishin rifilluar.

Duke folur për Marrëveshjen e Përbashkët të Mbrojtjes në Mekë, Sharif tha se pakti i nënshkruar nga Turqia, Arabia Saudite dhe Pakistani “nuk është i drejtuar kundër asnjë vendi”, por përfaqëson një angazhim për mbrojtje, stabilitet dhe paqe në rajon.

Sharif: Uji nuk duhet të përdoret si armë

Kryeministri pakistanez foli edhe për Traktatin e Ujërave të Industisë dhe marrëdhëniet me Indinë, duke theksuar se “uji nuk duhet të përdoret kurrë si armë”.

“Çdo përpjekje për të ndaluar, penguar ose devijuar pjesën e ujërave të Pakistanit do të trajtohet si një akt lufte”, deklaroi Sharif.

Ai falënderoi presidentin amerikan Donald Trump për ndërmjetësimin e armëpushimit mes Indisë dhe Pakistanit, duke thënë se kjo kishte shpëtuar “qindra miliona jetë në Azinë Jugore”.

Çështja e Kashmirit

Sa i përket Kashmirin, Sharif tha se Pakistani do të vazhdojë të ofrojë “mbështetjen e plotë diplomatike, politike dhe morale” deri në realizimin e asaj që ai e cilësoi si të drejtën e kashmirianëve për vetëvendosje.

“Kashmiri ka qenë dhe do të jetë gjithmonë vena jugulare e Pakistanit!”, tha ai.

Sharif shprehu gjithashtu shqetësim për atë që e cilësoi si rritje të islamofobisë, duke theksuar se urrejtja fetare nuk duhet të ketë vend në shoqëri.

Në përfundim, kryeministri pakistanez tha se vendi i tij ka zgjedhur “dialogun mbi konfrontimin”, “bashkëpunimin mbi shtrëngimin” dhe “paqen mbi luftën”, duke bërë thirrje për rikthimin e besimit dhe ruajtjen e paqes.

Artikuj te sugjeruar

BOTA 25 Shtator 21:42

[Dokumentet tronditëse/ Hitleri vrau mbesën e tij? Zbulimi i rrallë prej gati 1 shekulli: Ishte i dashuruar me të](#)

Angela 'Geli' Raubal, 23 vjeçe, u gjet e vdekur me një plagë arme zjarri në gjoks, ndërsa arma ishte një pistolet&eu...

BOTA 25 Shtator21:24

[“Më mirë një grua pak tërheqëse, por besnike, sesa...”/ Deklarata që trazoi politikën italiane](#)

Zëvendëskryeministri italian dhe udhëheqësi i Forza Italia, Antonio Tajani ka ndezur polemika të forta në vendin fqinj, me deklara...

BOTA 25 Shtator20:45

[Netanyahu u bojkotua masivisht në OKB/ Zyrtares izraelit kontrollon sallën, shënoi se kush iku gjatë fjalimit](#)

Delegacioni izraelit është parë duke lëvizur nëpër sallën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të ...

BOTA 25 Shtator20:43

[Hynin nëpër puseta në Nju Jork, arrestohen “njerëzit urith”](#)

Dy “gjuetarë nate” pa shumë mend në kokë, mes tyre edhe një person veçanërisht i shëndoshë, të c...

BOTA 25 Shtator20:42

[Megaskandali me fondet e investimeve në Turqi, nën hetim 76 persona, 45 në pranga](#)

Një total prej 45 personash janë arrestuar në Turqi në një hetim mbi një skandal që përfshin fondet e investimeve, than&...

BOTA 25 Shtator20:26

[“Operacionit Vivaldi”, ofensiva që po i jep Ukrainës terren në Donetsk](#)

Ukraina pretendon se ka rimarrë së fundmi rreth 125 kilometra katrorë territor pranë qytetit Lyman, në rajonin lindor të Donetsk-u...

BOTA 25 Shtator19:51

[VIDEO/ Banditi grabit traktorin dhe pas arratisjes me shpejtësi shkatërron shtëpinë e rivalit](#)

Ky është momenti kur një bandit nxiton me shpejtësi në rrugë me një traktor të vjedhur, përpara se ta përplas&...

BOTA 25 Shtator19:30

[Nga një milici lokale, në forcë të armatosur me raketa/ Pse huthit janë bërë kaq të rrezikshëm?](#)

Përballë Arabisë Saudite, që vetëm në vitin 2025 shpenzoi rreth 83 miliardë dollarë për mbrojtjen dhe zotëron ...

BOTA 25 Shtator18:35

[Parashikimi i tmerrshëm i Bill Gates: Inteligjenca artificiale mund të shkaktojë vdekjen e një miliard njerëzve](#)

Bill Gates bëri një deklaratë tronditëse, duke vlerësuar se inteligjenca artificiale mund të shkaktojë vdekjen e një mil...

BOTA 25 Shtator18:08

[Tensione në qiell/ Avionët e Suedisë dhe Finlandës "lojëra lufte" me avionët e Rusisë](#)

Forcat ajrore finlandeze thanë të premtën se avionë luftarakë suedezë dhe finlandezë ishin ngritur në ajër për t&eu...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 25 Shtator

[“Më quajti lopë kur isha shtatzënë”/ Pas videos...](#)

Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Kom...

AKTUALITET 24 Shtator

[Prova që fundosi shefin e Policisë Shkencore, d...](#)

Një akt-ekspertimi për makinën “Land Rover Defender”, i kryer me kërkesë të SPAK nga Policia Shkencore, ka mbërit...

SHOWBIZ 25 Shtator

["Fjeta milioner dhe u zgjova i rrënuar", Robert...](#)

Roberto Carlos ka rrëfyer një nga periudhat më të errëta të jetës së tij, duke zbuluar kalvarin me të cilin u p&eu...

INVESTIGIME 25 Shtator22:04


[Eyerje ndaj nxënësve, ngacmime e shkelje rregulloreje/ Kush është nëndrejtori problematik?](#)


Piranjat trajtuan rastin e një shkolle 9-vjeçare në Marqinet të qytetit të Vorës, ku prej dhjetorit të vitit 2025, katë...

video



Institucionet në shërbim të krimit: Pse hesht kryeministri për skandalet?






Institutionet në shërbim të krimit: Pse hesht kryeministri për skandalet?



Nga tritoli te kërcënimet me jetë: Çfarë po ndodh me policin Altin Preka?



Porti i Durrësit po mbyllet, investimet në infrastrukturë vazhdojnë. Cili është justifikimi i APD?



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.